

ZORVEC VINABEL

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



GHS07 GHS09

“Lexo fletudhëzuesin para përdorimit” “Rrezik”

ZORVEC VINABEL është një fungicid me veprim parandalues për kontrollin e vrugut të hardhisë. Produkti ka një lëvizje translaminare, një sistem ksilemi dhe një veprim kontakti.

Përmbajtja: *Zoxamide 300 g/L+oxathiapiprolin 40 g/L;*

Formulimi: Suspo-emulsion.

Përmban përzierje: 5-chloro-2-methyl-2H-isothiazol-3-one e 2-methyl-2H-isothiazol-3-one.

GRUPI	22	49	FUNGICID
-------	----	----	----------

Deklaratat parandaluese:

- P102 Mbajeni larg fëmijëve;
- P261 Mos thithni pluhurin/tymin/gazin/mjegullën/avujt/spërkatjen;
- P273 Shmangni shkarkimet, derdhjet në mjedis;
- P280 Vishni dorashka mbrojtëse/rroba mbrojtëse/mbrojtëse për fytyrën /sytë;
- P362+P364 Hiqni rrobat e kontaminuara dhe lajini përpara ripërdorimit;
- EUH 401- Për te shmangur risqet ndaj shëndetit njerëzor dhe mjedisit, zbatoni udhëzimet për përdorimin.
- P391 Mblidhni derdhjet;
- P501 Shkatërroni përmbajtjen/kontejnerin në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Informacion për ndihmën e parë:

- Në rast thithjeje, nxirreni në ajër të pastër dhe nëse është e nevojshme jepni oksigjen ose siguroni frymëmarrje artificiale, duke konsultuar menjëherë mjekun tuaj.
- H317 Ndjeshmëri/Sensitizim-Lëkura. Mund të shkaktojë një reaksion alergjik lëkure; P302+P352 NE RAST KONTAKTI ME LEKUREN: lahuni mirë me sapun dhe ujë; P333+P313 Nëse shfaqet acarim ose skuqje e lëkurës: Merrni këshilla/vëmendje mjekësore;
- Në rast kontakti të zgjatur me sytë, shpëlajeni menjëherë dhe me bollëk me ujë, gjithashtu nën qepalla, për të paktën 15-20 min dhe konsultohuni me mjekun.
- Në rast të gëlltitjes, pini 1 ose 2 gota ujë dhe shmangni nxitjen e të vjellave pa këshillën e mjekut. Mos i jepni asgjë nga goja një personi pa ndjenja. Terapia: simptomatike.
- Nuk ka raste të njohura të intoksikimit të njerëzit dhe/ose gjitarët. Në rast aksidenti ose nëse nuk ndiheni mirë, kërkoni kujdes të menjëhershëm mjekësor ose një qendër kontrolli helmimi.
- Në rast urgjence, lajmëroni menjëherë dhe qendrat për trajtimin në rast helmimesh.

Përdorimi:

Në Hardhi: Për luftimin e *Vrugut (Plasmopara viticola)*, me dozë 0,5 – 0,6 L/ha me vëllim solucioni 400-1200 litra/ha, duke u kujdesur që bima të laget mirë.

Kryeni maksimumi 2 aplikime në vit me një interval prej 10-14 ditësh, duke respektuar intervalin më të shkurtër në rast të presionit të lartë të patogjenit dhe kushteve klimatike të favorshme për zhvillimin e tij.

Përgatitja e solucionit

Sigurohuni që pajisjet janë të pastra dhe funksionale. Kalibroni sprucatorët që të keni hedhje uniforme. Mbushni serbatorin për gjysëm me ujë. Filloni përzierjen. Tundni mirë kontejnerin me ZORVEC VINABEL dhe hidhni sasinë e nevojshme direkt në serbator. Vazhdoni me përzierjen ndërkohë që mbushni serbatorin me sasinë e nevojshme të ujit si dhe gjatë spërkatjes.

Sekuensa e përzierjes në pajisjet spërkatës:

Mund të bëni përzierjet për të gjitha formulimet duke ndjekur radhën e hedhjes së produkteve si më poshtë.

Lejoni kohën e mjaftueshme të përzierjes për secilin produkt.

1. Qeska të tretshme në ujë (WSB).
2. Granule të tretshme në ujë (SG).
3. Granula të dispersueshme në ujë (WG).
4. Pluhur i lagshëm (WP).
5. Koncentrat i suspensueshëm (SC).
6. Suspo emulsion (SE).
7. Koncentrate të suspensueshme me bazë vajore (OD).
8. Emulsion ujor (EW).
9. Koncentrat i Emulsionueshem (EC)
10. Plehra të tretshme në ujë.

Menjëherë pas trajtimit, zbrazi plotësisht serbatorin dhe shpëlani mirë të gjitha pjesët e spërkatësit (serbatori, tubat, sprucatorët). Gjatë pastrimit, merrni të gjitha masat e nevojshme të sigurisë.

Parandalimi i rezistencës

ZORVEC VINABEL është një përzierje e oxathiapiprolin (grupi FRAC 49) dhe zoxamide (grupi FRAC 22), substanca aktive me mekanizma të ndryshëm veprimi dhe për këtë arsye përfaqëson një zgjidhje të mirë për të parandaluar ose vonuar fillimin e rezistencës. Megjithatë, këshillohet përdorimi i produktit në një program mbrojtës që parashikon përdorimin e anti-vrugjeveme mekanizëm të ndryshëm veprimi.

Kufizimet e mëposhtme duhet të merren parasysh kur aplikoni ZORVEC VINABEL ose çdo fungicid tjetër që përmban një substancë aktive që i përket grupit FRAC 49: Produkti duhet aplikuar si parandalues.

Rekomandohet kryerja e një numri trajtimesh me ZORVEC VINABEL jo më shumë se një e treta e numrit total të aplikimeve me produkte për mbrojtjen e bimëve me veprim kundër vrugut.

Aplikoni ZORVEC VINABEL (ose çdo formulim tjetër që përmban një substancë aktive që i përket Grupit 49 FRAC) si parandalues dhe jo më shumë se 2 herë në sezon.

Çdo fungicid i aplikuar pas trajtimeve me ZORVEC VINABEL duhet të ketë një mekanizëm të ndryshëm veprimi dhe mundësisht të jetë i pajisur me aktivitet kurues.

Mos e aplikoni produktin në fidanishte për prodhimin e filizave për mbjellje.

Paralajmërim: Në rast të përzierjes me formulime të tjera, duhet të respektohet periudha më e gjatë e pritjes. Duhet të respektohen gjithashtu rregullat paraprake të përshkruara për produktet më toksike. Në rast helmimi, informoni mjekun për përzierjen e kryer. ZORVEC VINABEL duhet të aplikohet në bimësi të thatë.

Fitotoksiciteti:

Nuk është fitotoksik kur përdoret me dozat dhe sipas rekomandimeve në këtë etiket.

Ndikimi në ekosistem:

H410 E rrezikshme për mjedisin ujor-Rreziku kronik. Shumë toksike për jetën ujore me efekte afatgjata; Mund të përdoret gjatë fazës së lulëzimit pasi nuk është helmues për bletët. Evitoni ndotjen e ujërave me kontejnerin ose produktin. Për të mbrojtur ujërat nëntokësore, mos aplikoni në tokat që përmbajnë një përçindje rëre më të madhe se 80%. Për të mbrojtur organizmat ujorë, mos e përdorni në një distancë më të shkurtër se 20 m nga sipërfaqet ujore. Evitoni pastrimin e pajisjeve pranë sipërfaqeve ujore.

Karenca:

28 ditë në hardhi.

Magazinimi:

Ruajeni të mbyllur hermetikisht në ambalazhin origjinal, në ambient të thatë, të venteluar mirë dhe sigurojeni nga rreziku i zjarrit.

Numri dhe data e regjistrimit: 789, datë 15.7.2022;

Sasia neto e PMB-së, që ndodhet në ambalazhin bazë: Deri 1 lit;

Numri i serisë ose shenja të tjera identifikuese: _____;

Data e prodhimit: _____;

Data e skadencës së PMB-së, ruajtur sipas kërkesave të përcaktuara në dosje: 3 vjet;

Lloji i ambalazhit bazë: Shishe HDPE dhe COEX;

Emri dhe adresa e kërkuesit: Corteva Agriscience International Sàrl. **Adresa:** Versoix, Zvicër;

Emri dhe adresa e prodhuesit: Corteva Agriscience International Sàrl. **Adresa:** Versoix, Zvicër.